



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstva Zdravstva - Ministry of Health

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Bolnička i Klinička Univerzitetska Sluzba Kosova (BKUSK)

The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
SHËRBIMI SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS -
UNIVERSITETSKA BOLNIČKA I KLINIČKA SLUŽBA KOSOVA -
THE HOSPITAL AND UNIVERSITY CLINICAL SERVICE OF KOSOVO
ARKIVI QENDROR - CENTRALNI ARHIV - CENTRAL ARCHIVE
Nr. i njësies org. / org. jed. / org. unit: _____
Nr. i faq. / Br. str. / No. page: 9
Nr. Prot. / Broj. prot. / Prot. no.: 405/3
Datum / Date: 12.02.2026
PRISTINE - PRIŠTINA - PRISTINA

DATË/A:	12.02.2026
PËR/ZA/TO:	- z. Elvir Azizi – Drejtor i Përgjithshëm i SHSKUK-së, - z. Mentor Zejnullahu – U.D Drejtor i QKUK-së, - z. Fisnik Dobra – Kyesues i Komisionit,
NGA/OD/FROM:	- Dr. Tetore Olloni – Kryesuese e Bordit Drejtues të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) <i>Tetore Olloni</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim për Miratimin e Rregullores për Rregullorja Nr.01/2026 për Shfrytëzimin e Parkingut në Hapësirat e QKUK-së, me Nr. Prot:1433, Datë: 12.02.2026,

Të nderuar,

Ju njoftojmë se Bordi Drejtues i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), ka shqyrtuar kërkesën tuaj për miratimin e Rregullore Nr.01/2026 për Shfrytëzimin e Parkingut në Hapësirat e QKUK-së, me Nr. Prot: 1433, Datë: 12.02.2026,

Bordi Drejtues i SHSKUK-së ka miratuar Rregulloren në fjalë dhe të njëjtën jua përcjellim së bashku me Vendimin e Bordit Drejtues.

Me respekt,

Bordi Drejtues i SHSKUK-së

- Adresa: QKUK, Nr:10000, Prishtinë

- Nr i tel: 038 512 683



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
SHËRBIMI SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVES - UNIVERSITETSKA BOLNIČKA I KLINIČKA SLUŽBA KOSOVA - THE HOSPITAL AND UNIVERSITY CLINICAL SERVICE OF KOSOVO	
ARKIVI QENDROR - CENTRALNI ARHIV - CENTRAL ARCHIVE	
Nr. i njësis org org. jed org. unit	Nr Prot. Broj prot. Prot. no.
Nr. i faq. Br. str. No. page	Data Datum Date
8	405 12.02.26
PRISHTINE - PRIŠTINA - PRISTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstva Zdravstva - Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Bolnička i Klinička Univerzitetska Sluzba Kosova (BKUSK)
The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

Nr:04/2026

Datë: 12.02.2026

Prishtinë

Në bazë të Nenin 64 të Ligjit Nr. 04./L-125 për Shëndetësi, Nenin 14, Nenin 15, Nenin 16 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës si dhe Pikës 4 dhe 6 të Nenit 22 dhe Nenit 25 të Rregullores Nr.01/2024 të Punës së Bordit Drejtues të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Bordi Drejtues i SHSKUK-së mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja Nr.01/2026 për Shfrytëzimin e Parkingut në Hapësirat e QKUK-së, me Nr. Prot:1433, Datë: 12.02.2026,
2. Rregullorja Nr.01/2026 për Shfrytëzimin e Parkingut në Hapësirat e QKUK-së është pjesë e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Dr. Tetore OLLONI

Kryesuese e Bordit Drejtues të SHSKUK-së

Iu dërgohet:

- Anëtarëve të Bordit Drejtues,
- Sekretarit të Bordit Drejtues,
- Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-së,
- Departamentit Ligjor të SHSKUK-së,
- U.D Drejtorit të QKUK-së,
- Komisionit Punues për hartimin e Rregullores për Shfrytëzimin e Parkingut në Hapësirat e QKUK-së,
- Arkivit të SHSKUK-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Nr. i njesis orig		Nr Prot	1433
org.jed		Broj. prot.	
org.unit		Prot. no.	
Nr. i faq.	7	Data	12.02.26
Br. str.		Datum	
No. page		Date	
PRISHINE - PRISTINA - PRISTINA			



Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës- (SHSKUK)
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova- (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo- (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës- Universitetski Klinikcki Centar
Kosova – University Clinical Center of Kosovo

Drejtoria e shërbimeve të përbashkëta teknike-administrative (SHPTA)

REFERENCE:			
PËR/ZA/TO:	Bordin Drejtues të SHSKUK-së		
CC			
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Elvir Azizi, Drejtor i Përgjithshëm i SHSKUK-së		
NGA/OD/FROM:	Mentor Zejnullahu, U.D. Drejtor i QKUK-së Fisnik Dobra, kryesues i komisionit		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Drafti për parkingjet në QKUK		
Nr. i zyrës:	Lokacioni:	Datë:	
Br. kancelarije:	Kucni:	Datum:	11.02.2026
RoomNo.:	Extension:	Date:	

Të nderuar,
Bazuar në kërkesën tuaj, komisioni i emëruar ka bërë plotësim- ndryshimin e Draft-propozimit lidhur me hapësirat e parkingjeve në QKUK, të cilin e keni të bashkëngjitur me këtë shkresë.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВА - REPUBLIC OF KOSOVO	
SHËRBIMI SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS - UNIVERSITETSKA BOLNIČKA I KLINIČKA SLUŽBA KOSOVA - THE HOSPITAL AND UNIVERSITY CLINICAL SERVICE OF KOSOVO	
ARKIVI QENDOR - CENTRAL ARCHIVE - GENERAL ARCHIVE	
Nr. i njesis org. org. jed. org. unit	Nr Prot. Prot. no.
Nr. i faq. Br. str.	Data Date
No. page	
PRISHTINE - PRIŠTINA - PRISTINA	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government



Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës-SHSKUK)
 Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-(UBKSK)
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo-(HUCSK)
 Qendra Klinike Universitare e Kosovës-Univerzitetski Klinički Centar Kosova-
 University Clinical Center of Kosovo

RREGULLORE NR. - 01/2026

PËR SHFRYTËZIMIN E PARKINGUT NË HAPËSIRAT E QKUK-së

Në mbështetje të nenit 64 Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi, nenit 12, paragrafi 2, nën paragrafi 2.3 dhe nenit 15 të Statutit të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, Bordi Drejtues i SHSKUK-së, në mbledhjen e mbajtur më __/__/__ miraton:

RREGULLOREN E BRENDSHME PËR SHFRYTËZIMIN E PARKINGUT NË HAPËSIRAT E QKUK-së

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore përcakton kushtet, kriteret, procedurat e shfrytëzimit të parkingut në hapësirat e QKUK-së me qëllim shfrytëzimin sa më racional të këtij parkingu dhe lehtësimin e qasjes tek klinikat apo shërbimet nga pacientët të cilët kanë nevojë për shërbime shëndetësore.

Fusha e Zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për të gjithë personat që shfrytëzojnë hapësirat e parkingut në QKUK

Neni 3 Përkufizimet

Termat e përdorur për këtë Rregullore, kanë këtë kuptim:

1. **QKUK-** Qendra Klinike Universitare e Kosoves me seli në Prishtine
2. **Vend parking-** nënkupton hapësirë e destinuar për parkingun e automjeteve, e cila është e shënuar me shenja horizontale, vertikale.
3. **Vend parking i hapur-** është parkingu brenda hapësirave të QKUK-së në të cilin mund të parkohen të gjithë shfrytëzuesit.
4. **Vend parking i mbyllur-** është parkingu në hyrje të të cilit janë vendosur laura, dhe mund të shfrytëzohen vetëm nga personat të cilëve iu është lejuar hapja e laurës me kartelë.
5. **Shfrytëzues-** është çdo person i cili shfrytëzon parkingun e QKUK-së me automjetin e tij
6. **Shfrytëzues pa pagesë-** është çdo person i liruar nga pagesa, sipas legjislacionit në fuqi dhe kësaj rregullore.
7. **Shfrytëzues zyrtar-** është çdo person, punëtor, zyrtar i institucioneve të tjera të cilët posedojnë kartelën për hyrje-dalje të laurave në hyrjet e QKUK-së.
8. **Automjet** – është çdo mjet motorik.
9. **Kartelë për hyrje-dalje-** është kartelë që evidentohet me një numër identifikues, e cila përdoret për hapjen e laurave të cilat janë të vendosura në hyrje-daljet e QKUK-së.

Neni 4

Kushtet, kriteret dhe procedurat për paisje me kartela për laura

1. Të punësuarit në QKUK dhe SHSKUK, kategoria e specializanteve të cilët janë duke kryer shkollimin specialistik në QKUK, të angazhuarit në kujdestari më tepër se një muaj, paisen me nga një kartelë për hyrje-dalje në hapësirat e QKUK-së pa pagesë.
2. Të punësuarit në Fakultetin e Mjekësisë, Institutin e Mjekësisë Ligjore, Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale, Institutin Kombëtar, Transfuzionin e Gjakut, apo çdo institucion publik që gjendet me objekt në hapësirat e QKUK-së, të cilët posedojnë automjet personal apo me autorizim ju takon e drejta për ta poseduar një kartelë për hyrje-dalje në QKUK (paisja me kartelë bëhet me pagesë nga këto institucione sipas çmimit kontraktues, ndërsa për herë të dytë e më tepër sipas kësaj rregulloreje).
3. Të gjithë të punësuarit nga paragrafi 1 i këtij neni që aplikojnë për herë të parë, këtë e bëjnë përmes administratës të klinikës apo shërbimit për QKUK, ndërsa për njësitë përbërëse të SHSKUK-së që veprojnë brenda oborrit të QKUK-së bëhet nga drejtori i Institucionit.
4. I autorizuari nga QKUK pasi shqyrton kërkesat, brenda afatit i paisë me kartela të punësuarit që plotësojnë kriteret sipas paragrafeve, të këtij neni.
5. Drejtori i Shërbimeve të Përbashkëta Tekniko Administrative (SHPTA), varësisht nga vlerësimi dhe kërkesa sipas këtij neni, ka të drejtë të refuzoj apo të aprovoj kërkesën.
6. Administratorët e klinikave janë të obliguar që çdo 3 muaj të bëjnë përditësimin e të dhënave të klinikave të tyre dhe menjëherë të lajmërojnë për ndryshimet e bëra.

Neni 5

Përdorimi i kartelave për hyrje-dalje

1. I punësuari i cili posedon kartelë për hyrje-dalje, është i obliguar ta përdorë vetëm për nevojat e tij.
2. Nëse vërtetohet që poseduesi i kartelës e ka keqpërdorë kartelën, përtej qëllimeve për të cilat i është dhënë, atëherë personi përgjegjës apo i autorizuarin nga QKUK kanë të drejtën e ndalimit të kartelës.
3. Çdo poseduesi të cilit i humb kartela, është i obliguar të njoftojë administratën e klinikës apo shërbimit brenda 24 orëve dhe të filloj procedurën për ndaljen e kartelës së humbur dhe paisjes me kartelë të re, ndërsa për dëmtimin fizik të kartelës poseduesi është i obliguar ta dorëzoj tek administrata e klinikës apo institucionit përkatës.
4. Për paisje me kartelë të re pasi e ka humb apo e ka dëmtuar fizikisht për herë të parë, i punësuari është i obliguar të paguaj shumën prej 10 Euro, për herën e dytë 15 Euro ndërsa për herën e tretë 20 Euro.
5. Institucioni është i obliguar të ia siguroj kartelën e re të punësuarit.
6. Të punësuarit që për arsye të ndryshme ndërprejnë marrëdhënien e punës administrata e klinikës apo shërbimit është e obliguar menjëherë ta bëjë lajmërimin për de-aktivizim të kartelës, kjo vlenë edhe për rastet e vdekjes.

Neni 6

Çmimi për kohën e shfrytëzimit të parkingut

1. Çdo person i cili me automjetin e tij shfrytëzon parkingun në hapësirat e QKUK-së është i obliguar të paguaj çmimin për kohën e shfrytëzimit si në vijim:
 - a) nga 01 min - 60 min, çmimi 1 euro;
 - b) 1 euro për orë (€/h).
2. Të gjithë operatorët ekonomik të cilët operojnë apo kryejnë punë brenda hapësirave të QKUK-së të bëjnë pagesën për të pasur qasje hyrje-dalje në hapësirat e QKUK-ës, të parapara sipas paragrafit 1 të këtij neni apo pagesa mujore 15€ për automjet për muaj (1X15=15 €); gjashtë (6) mujore 12 € për automjet për muaj (6X12=72 €); për automjet dhe në baza vjetore 10 € për automjet për muaj (12X10=120 €).

3. Paga bëhet në vendin e caktuar për paga të parkingut duke dorëzuar tiketën e cila përcakton kohën e shfrytëzimit të parkingut. Maksimumi i kohës së lejuar për qëndrim brenda oborrit të QKUK-së pas kryerjes së pagesës është 15 minuta.
4. Në rastet kur kemi donacione, qoftë në formë dhurimi të ndonjë pajisjeje apo veprimtari tjetër në dobi të QKUK-së, Drejtori i QKUK-së mund të marrë Vendim për ta liruar nga paga e hyrje haljeve, atë ose ato kompani për atë periudhë kohore.

Neni 7

Kategoritë që lirohen nga paga

1. Autoambulancat e të gjitha institucioneve shëndetësore publike.
2. Automjetet Zyrtare të institucioneve shtetërore të regjistruar me tabela zyrtare (vetëm për kryerjen e punëve zyrtare)
3. Automjetet e FSK-së, KFOR-it, Policisë së Kosovës, EULEX-it, Zjarrfikësit, Termokosit, KEDS-it, Ujesjellësit BATLLAVA.
4. Pacientët me sëmundje të rënda kronike dhe sëmundje malinje si:
 - a) Diabetes Mellitus tip 1 (E 10);
 - b) Diabetes Mellitus tip 2 insulin vartës (E 11);
 - c) Insuficienca kronike e veshkëve- pacientët në dializë (N 18);
 - d) Tuberkulozi (A 15- A 19);
 - e) HIV/AIDS (B 20- B 24);
 - f) Hemofilia (D 65- D 69);
 - g) Imunodeficienca (D 80- D 84);
 - h) Sëmundjet malinje (D 01- D09; C 00- C97);
 - i) Cirroza Hepatike (K 70- K 76);
 - j) LES M 32, M05, M06, M07, M34, M45;
 - k) Sarkoidoza (D86);
 - l) SPOK (J43, J44, J45, J46, J47, J96);
 - m) Demenca dhe psikoza kronike, retardimi, i rëndë (F00- F03; F20; F22; F25; F31; F32; F33; F34; F70; F71; F72; F73; F78; F79);
 - n) Sëmundjet e sistemit nervor (Parkinsonizmi, Skleroza multiple, Epilepsia, Miastenia Gravis, Distrofia muskulare, paraliza infantile spastike, hemiplegjia, paraplegjia, tetraplegjia) (G20, G35, G40, G70, G71, G8- G83);
 - o) Personat e verbër dhe të shurdhër (H54; H90; H91);
 - p) Personat për Fertilizim të Asistuar Mjekësor, për ciklin e parë dhe ciklin e dytë;
 - q) Të gjithë personat me paaftësi si dhe sëmundjet tjera të cilat i përcakton Ministria e Shëndetësisë.
5. Personat me nevoja të veçanta duhet t'a dëshmojnë me Librezën e lëshuar nga MPMS (percjellësit/prindit lirohen nga paga vetëm me prezencën e personit me nevoja të veçanta dhe raportin e mjekut të protokolluar ditën që ka kryer vizitën mjekësore).
6. Veteranët, invalidët dhe familjet e dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), duhet ta dëshmojnë me kartelën e lëshuar nga shoqatat e dala nga lufta dhe raportin e mjekut të protokolluar ditën që kanë kryer vizitën mjekësore).
7. Prindërit apo kujdestarët ligjor të fëmijëve të mitur deri në moshën 18 vjeç, të cilët sjellin fëmijët për vizita mjekësore në QKUK, përjashtohen nga paga për shfrytëzimin e parkingut gjatë kohës së vizitës mjekësore. Për të përfituar nga ky përjashtim, prindërit duhet të paraqesin një dokument mjekësor të lëshuar nga QKUK që vërteton vizitën mjekësore të fëmijës.

Neni 8

Mbikëqyrja e hyrje-daljeve

1. Drejtori i Shërbimeve të Përbashkëta Tekniko Administrative (SHPTA)-së autorizon me vendim të punësuarit nga njësia (sektori) e IT-së (ose ndonjë sektor tjetër që ka nën kompetencë laurat) për mbikëqyrjen e sistemit elektronik të laurave në hyrje-dalje.
2. Të autorizuarit për mbikëqyrje kanë qasje të pakufizuar në serverin qendror të sistemit të hyrje-daljeve.
3. Të autorizuarit janë të obliguar të njoftojnë në çdo kohë Drejtorin e SHPTA-së ose të autorizuarin për çdo parregullësi që hasin gjatë mbikëqyrjes, apo nëse vërejnë ndonjë keqpërdorim të kartelave për hyrje-dalje nga poseduesit.
4. Përgatisin raporte periodike, mujore, tre mujore, gjashtë mujore dhe vjetore për Drejtorin, apo sipas kërkesës së Drejtorit të Shërbimeve të Përbashkëta Tekniko Administrative (SHPTA).

Neni 9

Qasje në parkingun e drejtorëve

1. Në parkingun A të objektit të administratës është hapësira ku të drejtën për parkim të automjetit e kanë: Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së (hapësirë e rezervuar), Drejtori i Departamentit për shërbime Shëndetësore (SHSKUK), Drejtori i Departamentit për Buxhet dhe Financa (SHSKUK), Drejtori i Departamentit për Administratë dhe Shërbime të Përbashkëta (SHSKUK), Drejtori i Departamentit për Burime Njerëzore (SHSKUK), Drejtori i Departamentit Ligjor (SHSKUK), Udhëheqësi i Divizionit për Prokurim Publik (SHSKUK), Udhëheqësi i Divizionit të Auditimit (SHSKUK). Drejtori i QKUK-së (hapësirë e rezervuar), Drejtori i Shërbimeve të Përbashkëta Tekniko Administrative në QKUK (hapësirë e rezervuar), Shefi i Financave (QKUK), Shefi i Prokurimit (QKUK), Shefi i Zyrës Ligjore (QKUK), Shefi i Personelit (QKUK).
2. Në parkingun B vendosen Drejtorët e klinikave që nuk kanë parking te klinikat e tyre, anëtarët e Bordit drejtues të SHSKUK-së, shefat e sektoreve të SHSKUK-së dhe QKUK-së që punojnë dhe operojnë në objektin e Administratës që nuk janë përfshirë në parkingun A, Sekretari i Bordit Drejtues të SHSKUK-së.
3. Pasi të formulohet lista të lejuarve për qasje në Parking sipas këtij neni në paragrafin 1 dhe 2 duhet të jetë e aprovuar nga Drejtori i Shërbimeve të Përbashkëta Tekniko Administrative (SHPTA), për procedim të mëtejshëm të qasjes.

Neni 10

Përgjegjësia për demin material dhe jo material

4. QKUK nuk mban përgjegjësi në rast të ndonjë dëmi material apo jo material, në rast të vjedhjeve apo dëmtimit të automjeteve të shfrytëzuesve të parkingut.
5. Dëmet apo vjedhjet eventuale që mund të ndodhin në automjetet e shfrytëzuesve, i nënshtrohen procedurave ligjore në organet kompetente.

Neni 11

1. Ndalohet keqpërdorimi i kartelave për përfitime të poseduesit apo të personave tjerë.
2. Ndalohet nxjerrja e tiketës në hyrje nga poseduesit e kartelave.
3. Ndalohet huazimi i kartelës të punësuarve apo personave të tjerë.
4. Mos respektimi i rregullave të përcaktuara me këtë rregullore konsiderohet shkelje e rëndë e detyrave të punës e cila ka dëmtuar pronën e QKUK-së, dhe do të trajtohet sipas procedurave Disiplinore.

Neni 12

Dispozitat Shfuqizuese dhe tranzitore

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet Rregullorja për Shfrytëzimin e Parkingut në Hapësirat e QKUK/SHSKUK Nr.116 të datës 25.01.2019.
2. Për të gjitha kategoritë e liruara nga pagesa sipas dispozitave të Rregullores Nr.prot: 116 të datës 25.01.2019, leja për hyrje dalje vazhdon deri në skadimin e afatit për të cilin është nxjerrur.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Bordit Drejtues të SHSKUK-së.

Tetore Olloni


Kryesuese, Bordi Drejtues - SHSKUK